

VENDIM
Nr.608, datë 8.7.2010

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1135, DATË 5.8.2008 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË
SHTETIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 88 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, të nenit 32 të vendimit nr.804, datë 21.11.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së personelit të Policisë së Shtetit”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.1135, datë 5.8.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 1, lidhja nr.1 “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Shtetit”, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon;

“Specialistët”, “Përgjegjësit e Sektorit”, apo “Drejtorët” në Policinë e Shtetit, që punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit të veprimtarisë së Policisë së Shtetit dhe kërkojnë në mënyrë të detyrueshme Diplomë të Nivelit të Dytë (DND) ose Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë (DIND) apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët “Inxhinieri elektronike” apo “Informatikë”, përfitojnë një shtesë për “kushte pune”, prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh, mbi pagën mujore të gradës përkatëse. Zbatimi i kësaj shtese, për pozicionet konkrete, bëhet pas miratimit paraprak nga Departamenti i Administratës Publike dhe Ministria e Financave, sipas përshkrimit të pozicioneve të punës.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për rritjen e pagave të punonjësve të Policisë së Shtetit, do të përballohen nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit për rritjen e pagave, për vitin 2010.

3. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË SHTETIT

Niveli	Grada	Paga bazë për gradë	Shtesa për natyrë të veçantë pune e shërbimi										
			Në funksione organike për hetimin e krimeve kundër krimit të organizuar. Oficerët e Policisë Gjyqësore. Specialistë të policisë në zonë. Në funksione organike të mbrojtjes së të miturve dhe dhunës në familje. Në funksione të drejtorisë së bashkëpunimit dhe koordinimit ndërkombëtar	Në funksione të Forcës së Posaçme dhe Oficerë të Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë për Krimet e Rënda	Në funksione të sigurisë publike. Policia rrugore. Qendra e Emergjencave e sallave operative. Ruajtja e sigurisë e objekteve.	Në funksion e ndalim paraburgimi	Në funksione organike të Policisë Kufitare dhe Migracionit	Në funksione operuese të Forcave Speciale (Kom. rep. Zv/k rep Shef Shtabi në RENE. Reparti i helikopterëve Njësia Antieksplziv Njësia e Negociatorëve dhe Njësia e Lëvizshme Territoriale për Kufirin e Migracionin, si dhe reparti RESI)	Në funksione operuese Forcat e ndërhyrjes së shpejtë (k.rep/N/rep, Zv.k/rep shef shtabi)	Drejtor e Zv/drejtor i Policisë së Qarkut. Shef komisarati. Shef stacioni. Komandant i Repartit të Sigurisë së Brendshme e Ceremonialit	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkpunëtorëve të drejtësisë.	Në funksione të shërb. mbështetëse dhe administrative në Policinë e Shtetit.	Në funksione organike Drejtor dhe zëvendës drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit. Drejtor i Policisë së Qarkut Tiranë dhe Drejtor e Forcave të Lëvizshme Operacionale
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11		12	13
Niveli zbatues	Nëninspektor	35 600	6 500		5 500	6 500	5 500	40 000	7 000		30 000	2 000	
	Inspektor	39 000	6 500	16 500	5 500	6 500	5 500	40 000	7 000		30 000	2 000	
	Kryeinspektor	44 000	6 500	17 500	5 500	6 500	5 500	40 000	7 000		30 000	2 000	
Niveli i parë drejtues	Nënkomisar	53 000	6 500	18 500	5 500		5 500	40 000	7 000	6 000	30 000	2 000	
	Komisar	58 000	6 500	19 500	5 500		5 500	40 000	7 000	6 000	30 000	2 000	
	Kryekomisar	82 000	6 500	22 000	5 500		5 500	40 000	7 000	6 000	30 000	2 000	15 000
Niveli i mesëm drejtues	Drejtues	93 000	6 500	20 000	5 500		5 500	40 000	7 000	6 000	30 000	2 000	15 000
	Drejtues i I-rë	96 000	6 500		5 500		5 500	40 000	7 000	6 000	30 000	2 000	15 000
Niveli i lartë drejtues	Zv/drejtor i Përgjithshëm	106 000											15 000
	Drejtor i Përgjithshëm	115 000											20 000

